

VENDIM
Nr. 320, datë 31.5.2023

PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË
TRAJTIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË PËRDORIM, NË KUSHTET E NENIT 12,
TË LIGJIT NR. 20/2020

(Ndryshuar me VKM-në nr. 320, datë 29.5.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës ndërinstitucionale për mënyrën e trajtimit të pasurive të paluajtshme “tokë bujqësore”, në përdorim të personave fizikë (individë) pa titull pronësie, të cilët gjenden në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020.

2. Qëllimet e këtij vendimi dhe të veprimtarisë së Task-Forcës që krijohet nëpërmjet tij janë:

a) identifikimi i problematikave në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për tokat bujqësore në përdorim, pa titull pronësie;

b) hartimi i planit të veprimit për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës;

c) koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore, vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, në funksion të zgjidhjes përfundimtare të problematikave.

3. Task-Forca krijohet për njësi administrative territoriale të veçanta dhe përbërja e saj miratohet me urdhër të Kryeministrit. Task-Forca drejtohet nga kryetari dhe ka në përbërje të saj deri në një përfaqësues të secilit prej institucioneve të mëposhtme:

a) Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

ç) Ministria e Drejtësisë;

d) Agjencia e Trajtimit të Pronës;

dh) Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

4. Krahas anëtarëve të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, në veprimtarinë e Task-Forcës mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në njësinë administrative vendore pranë së cilës Task-Forca do të ushtrojë detyrat e saj.

5. Kryetari i Task-Forcës përgjigjet para Kryeministrit për veprimtarinë e Task-Forcës dhe raporton në mënyrë periodike çdo muaj pranë tij. Në rast se Kryetari nuk është njëkohësisht edhe punonjës në ndonjë nga institucionet e administratës shtetërore, ai trajtohet me pagë me nivelin e drejtorit të përgjithshëm të përmbajtjes në ministri.

6. Në mbështetje të veprimtarisë së Task-Forcës, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës formohet sekretariati teknik i saj, i përbërë nga punonjës të kësaj Agjencie. Punonjësit e sekretariatit caktohen nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së.

7. Objekt i veprimtarisë së Task-Forcës janë pasuritë e paluajtshme që plotësojnë këto kushte:

a) janë braktisur nga subjekti pretendues ligjor dhe nuk janë regjistruar pranë ASHK-së;

b) janë toka bujqësore (sipas zërave përkatës të saj);

c) nuk janë prona private të të tretëve;

c) nuk janë objekt i formave të kompensimit fizik, sipas legjislacionit në fuqi për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave;

d) nuk janë zënë nga ndërtimet pa leje të të tretëve apo të vetë subjektit kërkues;

dh) nuk janë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë;

e) nuk janë prona shtetërore të destinuara për qëllime turistike;

ë) nuk janë prona publike të patjetërsueshme;

f) nuk janë të zëna nga ndërtimet, objekt trajtimi, të nenit 34, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

8. Detyrat e Task-Forcës janë:

a) të evidentojë sipërfaqet që gjenden në kushtet e përcaktuara në pikën 7, të këtij vendimi;

b) të identifikojë poseduesit faktikë që zotërojnë sipërfaqet në fjalë dhe të hartojë një listë të posaçme për nevoja pune, në dispozicion të ASHK-së;

c) të analizojë nëse rrethanat e këtyre rasteve, në tërësi, përmbajnë ose jo premiset për fitimin e pronësisë, sipas mënyrave origjinale të parashikuara në Kodin Civil apo mënyrave të tjera të posaçme, të parashikuara në ligje të veçanta;

ç) të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim finalizimin e proceseve, për kërkesat e dorëzuara pranë këtij institucioni (ASHK) prej organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore;

d) të hartojë raporte periodike për problematikat e ndeshura, trajtimin e çështjes dhe identifikimin e zgjidhjes, në funksion të qëllimit të këtij vendimi;

dh) të bashkërendojë punën me institucionet e përfshira, në funksion të realizimit të detyrave;

e) të hartojë planin e veprimit për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës në lidhje me tokat bujqësore në përdorim të personave fizikë (individë) pa titull pronësie.

9. Për zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën 8, të këtij vendimi, Task-Forca mbështetet në strukturat administrative dhe burimet e institucioneve të përfshira në formimin e saj, sipas kompetencave dhe ekspertizës përkatëse.

10. Drejtuesit e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, i përcjellin sekretariatit të Task-Forcës emrat e përfaqësuesve të tyre brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

11. Task-Forca është e detyruar të përmbushë detyrat e përcaktuara në pikën 8, të këtij vendimi, brenda 2 (dy) viteve nga hyrja e tij në fuqi.

12. Task-Forca, në funksion të zbatimit të detyrave të saj, mund të kërkojë informacion pranë institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, dhe çdo institucion tjetër që zotëron të dhëna dhe dokumentacion që i shërben qëllimit të veprimtarisë së saj. Këto institucione janë të detyruara t’i përgjigjen asaj në përputhje me afatet e përcaktuara në aktin nënligjor në fuqi mbi procedurat e bashkëpunimit të organeve të administratës shtetërore.

13. Shpenzimet për pagën e kryetarit të Task-Forcës, nëse është punonjës i institucioneve të administratës shtetërore, paguhet nga institucioni ku është i punësuar. Nëse nuk është i tillë, ato përballohen nga Kryeministria.

14. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku